

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

31 mars 2010
Prishtinë
Ap.-Kž. Nr. 282/09

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari ndërkombëtar Guy van Craen si Kryetar i kolegjit, Gjyqtari ndërkombëtar Emilio Gatti, dhe Gjyqtarja e Kosovës Emine Mustafi si anëtarë të kolegjit, në procedurën penale kundër:

B. R. tani në paraburgim sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë P.Nr. 570/07 të datës 27 maj 2009, nuk është i dënuar më parë;

V. A. tani në paraburgim sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë P.Nr. 570/07 të datës 27 maj 2009, nuk është i dënuar më parë;

V. V. tani në paraburgim sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë P.Nr. 570/07 të datës 27 maj 2009, nuk është i dënuar më parë;

V. S. tani banon në Rugën Fitorja në Podujevë.

Duke vendosur mbi ankesën e paraqitur më 1 korrik 2009 nga ana e Prokurorit të PSRK-së, ankesën e paraqitur më 8 korrik 2009 nga Avokatja **V. B.** në emër të të pandehurit **V. S.**, ankesën e paraqitur më 27 korrik 2009 nga Avokat **H. M.** në emër të të pandehurit **V. V.**, ankesën e paraqitur më 29 qershor 2009 nga Avokat **N. L.** në emër të të pandehurit **V. A.**, dhe ankesën e paraqitur më 30 qershor 2009 nga Avokat **M. H.** në emër të të pandehurit **Beqim Rashit**, ku të gjitha kundërshtojnë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 570/07 të datës 27 maj 2009, që shpalli katër të pandehurit fajtor për veprën penale të Rrëmbimit të personit, në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 159, Paragrafit 2 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Pas dëgjimit të parashtrësive të ankuesve në seancën e mbajtur më 30 mars 2010 dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 30 mars 2010.

Duke vepruar sipas nenit 420 të KPPK-së dhe nenit 51 Ligjit për të Mitur lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur më 8 korrik 2009 nga Avokatja V [REDACTED] B [REDACTED] në emër të të pandehurit V [REDACTED], është e pabazuar dhe prandaj refuzohet tërësi;

Ankesa e paraqitur më 27 korrik 2009 nga Avokati H [REDACTED] M [REDACTED] në emër të të pandehurit V [REDACTED] V [REDACTED], është e pabazuar dhe prandaj refuzohet tërësi;

Ankesa e paraqitur më 29 qershor 2009 nga Avokati N [REDACTED] I [REDACTED] në emër të të pandehurit V [REDACTED] A [REDACTED] është e pabazuar dhe prandaj refuzohet tërësi;

Ankesa e paraqitur më 30 qershor 2009 nga Avokati M [REDACTED] H [REDACTED] në emër të të pandehurit B [REDACTED] R [REDACTED] është e pabazuar dhe prandaj refuzohet tërësi;

Ankesa e paraqitur më 1 korrik 2009 nga Prokurori i PSRK-së pranohet pjesërisht dhe dënimi vërtetohet si në vijim:

- 7 vjet burgim për B [REDACTED] R [REDACTED]
- 4 vjet burgim për V [REDACTED] A [REDACTED]
- 5 vjet burgim për V [REDACTED] V [REDACTED]

Sipas nenit 391.5 të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit është përfshi në kohëzgjatjen e dënimit.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 570/07 i datës 27 maj 2009 vërtetohet në pjesët tjera.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë do ti mbulojnë katër të pandehurit

Paraburgimi ndaj të pandehurve vërtetohet.

Sot më 31 mars 2010
Ap.-Kz. Nr. 282/09

E përgatitur në Gjuhën Angleze si gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Kolegjit
Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme
Guy van Craen



Procesmbajtës
Gjyqtar i Ligjit i EULEX-it
Francesco Caruso

Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme
Emilio Gatti

Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës
Emine Mustafi

Këshilla Juridike

Kundër këtij Aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa (neni 430 i KPPPK-së). Vetëm kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e lejuar të paraqitet në Gjykatën e cila ka lëshuar vendimin në shkallë të parë, në afat prej 3 muajsh prej ditës së marrjes së të njëjtit vendim (neni 77 i Ligjit për të Mitur dhe neni 451 – 460 i KPPK-së).